



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:193815

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05642858

KE.nr. 262/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit ENTERMEDIA Sh.p.k me nr. unik identifikues 810499352 dhe me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga shoqëria e avokatëve “RPHS Law” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga Xhemajl Peçani, me objekt kontesti kompensim i dëmit real, fitimit të humbur dhe dëmit jo material, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 15.04.2024 në të cilin prezantuan të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me datën 30.04.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit ENTERMEDIA Sh.p.k me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që në emër të eliminimit të kundërligjshëm nga aktiviteti i prokurimit nr. 320/14/023/111 i datës 16.04.2014 me titull “Informim publik për zgjedhjet e përgjithshme 2014” t’ia paguaj paditësit dëmin real në shumë prej 38,114.00 EUR, në emër të fitimit të humbur shumë prej 42,894.00 EUR si dhe në emër të dëmit jo material shumë prej 15,000.00 EUR, apo në total shumë e përgjithshme prej 96,008.00 EUR, me kamatë ligjore prej 8% në vit, dhe atë duke e llogaritur nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.
- II. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi ENTERMEDIA Sh.p.k me seli në Prishtinë, me datë 03.07.2014 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike kundër të paditurës Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit real dhe fitimit të humbur.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë, sipas kompetencës lëndore është transferuar pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike.

Në padi, si dhe përgjatë seancës përgatitore, paditësi ka theksuar se si një prej kompanive lidere dhe më prestigjioze në Kosovë dhe regjion për prodhimin e materialeve filmike dhe udhëheqjen e kampanjave të filmimit, ka marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit “Informimi Publik për Zgjedhjet e Përgjithshme 2014” i shpallur me datën 14 Prill 2014. Pas shpalljes se këtij njoftimi për kontrate dhe pas hapjes se ofertave me date 02 Maj 2014 oferta e paditësit është shpallur oferta me e lirë, ndërsa oferta e kompanisë MDA si me e shtrenjta. Ka shtuar se në këtë procedurë të prokurimit paditësit me qëllim i është dërguar dosja e falsifikuar te cilës i kanë munguar dy faqe, krejt kjo me synimin që oferta e paditësit të shpallet si ofertë e papërgjegjshme. Pasi që e paditura me datën 08 Maj 2014 ka anuluar ne tërësi tenderin e hapur, me datën 13 Maj 2014 tanimë e paditura ka hapur tender me procedure të kufizuar përmes negociimit me vetëm një kompani, duke shpallur njoftimin për dhënie të kontratës për operatorin ekonomik MDA me çmimin prej 358,019.95 EUR. Ka shtuar se paditësi ka parashtruar ankesë me datë 16.05.2014 për dy veprimet e të paditurës dhe atë për anulimin e aktivitetit të prokurimit 320/14/23/111 si dhe negociimin pa publikim paraprak lidhur me aktivitetin e prokurimit me nr. 320/14/23/115, dhe e cila ankesë, është aprovuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes vendimit të datës 04 qershor 2014, me të cilën është shpallur nule kontrata e nënshkruar nga KQZ me arsyetimin se paditësi është diskriminuar, se ne këtë aktivitet të prokurimit ka pasur falsifikim të dosjes së tenderit dhe se kontrata ne mes të KQZ dhe MDA është nënshkruar nga një person pa kompetencë nga ana e KQZ-së. Përkundër kësaj e paditura e ka zbatuar ne tërësi këtë kontrate me MDA-n. duke i kryer pagesat ne përputhje me këtë kontrate.

Përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke theksuar se pas administrimit të provave, baza juridike është vërtetuar ne tërësi, andaj ka konsideruar se caktimi i ekspertizës financiare ka qenë i nevojshëm për

përcaktimin e demit material dhe fitimin e humbur ndaj paditësit, e rrjedhimisht edhe aprovimit të padisë së paditësit.

I padituri me përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktiviteti i prokurimit lidhur me tenderin për informimin publik për zgjedhjet e parakohshme 2014 ishte zhvilluar në dy procedura, në procedurë të hapur me publikim të njoftimit të kontratës me të cilën dosjen tenderike përmes postes elektronike e ka tërhequr edhe OE Entermedia dhe 2) në procedurë të negociuar pa publikim të kontratës të cilat janë të ndara njëra me tjetrën. Ka sqaruar se tenderi i parë me procedurë të hapur nuk ka mundur të përfundojë për arsye se Presidentja e Republikës së Kosovës ka shpallur zgjedhje të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2014. Pra, bazuar në raportin preliminar të vlerësimit në këtë procedurë të hapur nuk është shpallur fituesi, ndërsa aktiviteti i prokurimit është anuluar konform nenit 62 të Ligjit të prokurimit publik për shkak të shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Për anulimin e këtij tenderi janë njoftuar të gjithë operatorët ekonomik me datë 12.05.2014 përfshirë edhe paditësin, të cilët sipas Ligjit të prokurimit Publik kanë pasur mundësi të parashtrajnë ankesë në kuptim të nenit 53 par.1 por këtë gjë nuk e kishin bërë asnjë operatorë.

Ka sqaruar se meqenëse e paditura është ndodhur në një gjendje urgjente për shkak të shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme nga Presidentja, e njëjta është detyruar që aktivitetin e ri të prokurimit “Informimi publik për zgjedhjet e parakohshme 2014” ta zhvillojë në procedurë të negociuar” ku lidhur me këtë aktivitet, e paditura ka lidhur kontratën me operatorin ekonomik MDA. Ka sqaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse se Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se paditësi është shpallur kundërligjshëm si operator i pa përgjegjshëm dhe se i njëjti është diskriminuar për shkak të falsifikimit të dosjes së tenderit, kjo sepse OSHP ka miratuar ankesën e paditësit vetëm sa i përket dërgimit të dosjes së tenderit, por nuk e ka anuluar kontratën, kontrata nga ky organ është anuluar vetëm për faktin se kjo kontratë nuk është nënshkruar në përputhje me nenin 26 lidhur me nenin 19 par.1 të LPP-së, konkretisht nga zyrtari më i lartë administrativ- kryetarja e KQZ, ashtu që OSHP ka detyruar të paditurën që përsëri të lidh kontratë me operatorin ekonomik MDA, në përputhje me nenin e lartcekur. Ka njoftuar gjykatën se lidhur me pretendimet e paditësit për falsifikim të dokumenteve nga zyrtarët e të paditurës, është iniciuar procedurë penale, ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të datës 15 Tetor 2019 është konstatuar se drejtori i prokurimit dhe krye shefi ekzekutiv nuk kanë kryer veprën penale lidhur me pretendimet e palës paditëse për falsifikim të dokumenteve, favorizim

te operatoreve ekonomik. Gjykatës i ka kërkuar që padinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor të datës 15.04.2024 ka bërë administrimin e provave si në vijim: Vendimi PSH.nr. 132/14 i datës 02.06.2014 i lëshuar nga OSHP; Akt përcjellës nr.132/14 i datës 26.05.2014; Vendim PSH.nr.132/14 i datës 26.05.2014; Raport i Vlerësimit nr.Prot.840/2014 i datës 10.05.2014; Njoftimi për kontratë i datës 14.04.2014; Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr.320/14/023/111 i datës 08.05.2014; Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit 320/14/023/115 i datës 22.05.2014; Dosja e tenderit e datës 16.04.2014 lidhur me aktivitetin e prokurimit nr.320/14/023/111; Kontrata me nr. të prokurimit 320/14/023/115 e datës 15.05.2014; Njoftimi nr. prot. 855/14 i datës 12.05.2014; Vendimi nr.810/14 i datës 08.05.2014 për shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme; Komunikimi elektronik i datës 12 Maj 2014, 21 Maj 2014, 30 Prill 2014, 22 Maj 2014; Procesverbali i hapjes së tenderit i datës 16.04.2014; Ankesa e paditësit e datës 16.05.2014; Aktgjykimi PML.nr. 180/19 i datës 15.10.2019 nga Gjykata Supreme e Kosovës;

Gjykata pasi ka bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa bazuar, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për arsyet si në vijim:

Nga njoftimi për kontratë i datës 14.04.2014 gjykata vërtetoi faktin se e paditura, ka hapur aktivitetin e prokurimit nr. 320-14-023-111 me titull “Informimi publik për zgjedhjet e përgjithshme 2014” duke aplikuar procedurë të hapur të tenderimit dhe atë të ndarë në tre (3) lloje.

Nga raporti i vlerësimit nr.prot.840/2014 i datës 10.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se komisioni për vlerësimin e tenderit pranë të paditurës, pas vlerësimit të ofertave në aktivitetin e prokurimit nr. 320-14-023-111, ka ardhur në përfundim se oferta e përgjegjshme përfshin operatorin ekonomik MDA për lloton 1 dhe 2, si dhe operatorin ekonomik ASHA Group për lloton 3.

Nga Vendimi nr.810/14 i datës 08.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se Presidentja e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës,

dhe atë me datë 08.06.2014. Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr.320/14/023/111 i datës 08.05.2014;

Nga Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr.320/14/023/111 i datës 08.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se e paditura, ka anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit “Informimi publik për zgjedhjet e përgjithshme 2014”, kjo për faktin se Presidentja e Republikës së Kosovës, ka bërë shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme me datë 08.06.2014, andaj aktiviteti i tillë i prokurimit me procedura e hapur e tenderimit nuk mund të përfundoj deri në datën e zgjedhjeve të parakohshme.

Nga njoftimi nr. prot. 855/14 i datës 12.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se Drejtori i Prokurimit i të paditurës ka njoftuar Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, se lidhur me aktivitetin “Informimi publik për zgjedhjet e përgjithshme 2014” tanimë do të aplikohet procedurë e negociuar e tenderimit, kjo për shkak të afateve të shkurtra kohore”.

Nga kontrata me nr. të prokurimit 320/14/023/115 e datës 15.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se e paditura, duke aplikuar procedurë të negociuar të tenderimit, ka lidhur kontratën me operatorin ekonomik MDA në lidhje me aktivitetin e prokurimit “*Informimi publik për zgjedhjet e parakohshme 2014*”.

Nga ankesa e paditësit e datës 16.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësi, ka drejtuar ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me nr. 320/14/023/115 “Informimi publik për zgjedhjet e parakohshme 2014”.

Nga vendimi nr. PSH.nr.132/14 i datës 26.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pezulluar aktivitetin e prokurimit nr.320/14/023/115 “*Informimi publik për zgjedhjet e parakohshme 2014*” derisa Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të kompletoj dosjën e tenderit dhe ta dorëzoj pranë OSHP-së.

Nga vendimi PSH.nr.132/14 i datës 26.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka vendosur për heqjen e pezullimit automatik të aktivitetit të prokurimit “Informimi publik zgjedhjet e parakohshme 2014” me nr. të prokurimit nr.320/14/023/115.

Nga vendimi PSH.nr. 132/14 i datës 02.06.2014, gjykata vërtetoi faktin se Organi Shqyrtues i Prokurimit, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar ankesën e operatorit ekonomik këtu paditësit Entermedia si të bazuar, në pikën II ka urdhëruar autoritetin kontraktues këtu të paditurën që në

emër të shpenzimeve procedurale, konform neni 35 të rregullores së OSHP-së, t'ia kompensoj paditësit vlerën prej 350.00 EUR në afat prej dhjetë (10) ditësh nga pranimi i vendimit, në pikën III të vendimit e ka anuluar dhe shpallur nule kontratën e lidhur nga e paditura KQZ me operatorin ekonomike MDA në Prishtinë të datës 15.04.2024 me arsyetimin se e njëjta është nënshkruar në kundërshtim me nenin 25 lidhur me nenin 19 par.1 të LPP-së, ndërsa me pikën IV të vendimit, ka urdhëruar autoritetin kontraktues, këtu të paditurën, që kontratën për aktivitetin e prokurimit “Informimi publik zgjedhjet e parakohshme 2014”, me nr. të prokurimit 320/14/023/115 të lidh përsëri me operatorin ekonomik MDA, konform neni 26, par.2 lidhur me nenin 19 par.2 të LPP-së.

Nga aktgjykimi PML.nr. 180/19 i datës 15.10.2019 konstatohet se Gjykata Supreme e Kosovës, ka marrë aktgjykim lirues ndaj N.H., zyrtar i të paditurës, lidhur me dyshimin se i njëjti kishte kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe autoritetit zyrtar, përmes falsifikimit të dokumenteve në dosjen e tenderit në dëm të këtu palës paditëse Entermedia sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Informimi publik zgjedhjet e përgjithshme 2014”, me nr. të prokurimit 320/14/023/111

3. Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Meqenëse raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse është krijuar në vitin 2014, për vendosje në këtë çështje juridike kontestimore gjykata iu referua Ligjit nr. 04/L-77 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje si LMD).

Sipas Nenit 136.1 të LMD-së përcaktohet që “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Referuar dispozitës së lartcekur, për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit duhet të përmbushen kushtet e përgjegjësisë dhe atë : të ekzistojë përgjegjësia e të paditurit, të ekzistojë fakti dëmtues, lidhja shkakore ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar dhe kundërligjshmëria e veprimit më të cilin është shkaktuar dëmi.

Në rastin konkret, nga vlerësimi i gjithmbarshëm i provave të administruara, gjykata erdhi në përfundim se paditësi nuk ka arritur të vërtetoj kundërligjshmërinë e veprimeve nga ana e të paditurës si kushte imperativ për mbështetje të kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit.

Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që Njoftimi i të paditurës nr.320/14/023/111 i datës 08.05.2014, për anulimin e aktivitetit të prokurimit “Informimi mbi zgjedhjet e përgjithshme

2014”, në të cilin aktivitet kishte marrë pjesë paditësja, nuk i është nënshtruar kontrollit të ligjshmërisë nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit, kjo sepse paditësja nuk ka parashtruar fare mjetin juridik të ankesës në kuptim të nenit 109 të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik. Andaj, përderisa njoftimi i lartcekur ka mbetur në fuqi dhe nuk është anuluar në procedurë administrative apo në procedurën e konfliktit administrativ, i njëjti prodhon pasoja juridike të vlefshme, ashtu që nuk mund të pretendohet shkaktimi i dëmit si rezultat i këtij njoftimi.

Ndërsa, në raport me aktivitetin e prokurimit “Informimi mbi zgjedhjet e parakohshme 2014”, në të cilin aktivitet e paditura ka zhvilluar procedurë të negociuar për shkak të shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme nga Presidentja e Kosovës duke lidhur kontratë me një operator tjetër ekonomik dhe jo me paditësin, Organi Shqyrtues i Prokurimit, me vendimin PSH.nr. 132/14 të datës 02.06.2014, përkundër që në pikën I dhe II të tij ka aprovuar ankesën e paditëses dhe ka urdhëruar të paditurën që t’i kthej paditësit shpenzimet e tenderimit, ky organ, në pikën V të saj, përsëri ka urdhëruar të paditurën që lidhur me këtë aktivitet, ta lidh kontratën me operatorin tjetër ekonomik MDA dhe jo këtu me palën paditëse.

Kësisoj, përkundër që pika V e vendimit PSH.nr. 132/14 të datës 02.06.2014 të OSHP-së ka pasur efekt direkt në interesat e paditësit, ky i fundit përsëri nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion, konkretisht nuk ka ushtruar padi në konflikt administrativ siç parashihet me nenin 108 të Ligjit për Prokurimin Publik për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit me të cilin është vendosur që lidhur me aktivitetin e prokurimit “Informimi mbi zgjedhjet e parakohshme 2014”, të lidhet kontratë me operatorin ekonomik MDA dhe jo me paditësin. Rrjedhimisht, në mungesë të kontrollit të ligjshmërisë së vendimit të lartcekur nga gjykata në procedurën e konfliktit administrativ, dhe në mungesë të tagrit të gjykatës në procedurë kontestimore që të shqyrtoj ligjshmërinë e vendimeve të organit administrativ, në këtë rast të Organit Shqyrtues të Prokurimit, vendimi PSH.nr. 132/14 të datës 02.06.2014 ka mbetur në fuqi, ashtu që të gjitha pasojat juridike që ka prodhuar ky vendim konsiderohen të ligjshme.

Gjykata pati parasysh pretendimet e paditësit se e paditura i ka pamundësuar që të shpallet fitues e rrjedhimisht të realizoj fitim në aktivitetin e prokurimit “Informimi mbi zgjedhjet e përgjithshme 2014” për shkak të falsifikimit të dokumentacionit të tenderit, fakt këtë që paditësi pretendon të jetë konstatuar me vendimin PSH.nr.132/14 i datës 26.05.2014, por që të njëjtat i vlerësoi si të paqëndrueshme pasi që lidhur me këto pretendime, ndaj zyrtarëve të të paditurës është iniciuar procedurë penale për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe e cila procedurë, ka

përfunduar me aktgjykim lirues, fakt ky që gjykata e konstatoi nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës PML.nr. 180/19 i datës 15.10.2019.

Andaj, në mungesë të një procedurë gjyqësore me aktgjykim të formës së prerë në konflikt administrativ apo eventualisht aktgjykim penal me të cilën konstatohet kundërligjshmëria e veprimeve të të paditurës, paditësi nuk ka arritur që të dëshmoj bazën juridike mbi të cilën e mbështet kërkesën e tij për kompensimin e dëmit për shkak të elemimit nga gara në një aktivitet të prokurimit.

Meqenëse paditësi nuk ka arritur të vërtetoj bazën juridike të kërkesëpadsisë, gjykata me aktvendimin procedural të marrë përgjatë seancës së datës 15.04.2024, ka refuzuar marrjen e provës me ekspertizë financiare për të përcaktuar lartësinë e dëmit eventual që paditësi ka pretenduar se i është shkaktuar nga veprimet e të paditurës, kjo meqenëse marrja e kësaj prove, nuk do kishte asnjë ndikim në vërtetimin e fakteve sa i përket bazës së kërkesëpadsisë së paditësit.

Gjykata pati parasysh edhe provat tjera të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, por gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe si nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi në mbështetje të nenit 450 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 262/22, datë 30.04.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.